



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 08.12.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L-040, nenit 9 dhe 10 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve dhe Përfundimit nr. 06-85343-3/1 të miratuar me dt: 03.12.2015 në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve, me të cilin është aprovuar kërkesa e OJQ “Thirrjet e Nënave” për ndihmë financiare për botimin e librit “Monografi për personat e rrëmbyer dhe të zhdukur, gjatë luftës në Kosovë, Gjakovë mars 1999-12 qershor 1999”, me dt: 08.12.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e OJQ “Thirrjet e Nënave” e evidentuar me nr. 01-400-85041 e dt:01.12.2015 për ndihmë financiare për botimin e librit “Monografi për personat e rrëmbyer dhe të zhdukur, gjatë luftës në Kosovë, Gjakovë mars 1999-12 qershor 1999”, duke e mbështetur këtë kërkesë nga linja e subvencioneve të Zyrës së Kryetares në vlerë prej 2,500.00€.

2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procesin e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 2,500.00€ nga mjetet e subvencioneve të Zyrës së Kryetares dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirollogarinë e OJQ “Thirrjet e Nënave”, nr. 1140087753000125 Procredit Bank.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

4. Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Kabineti i Kryetares
- Znj. Nesrete Kumnova, kryetare e OJQ “Thirrjet e Nënave”, Gjakovë
- Arkivit

Kryetarja e Komunës,

Znj. Mimoza Kusari-Lila